



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1212/11 Prot.

Tiranë, më 11.09.2020

V E N D I M

Nr. 37 datë 11.09 2020

**PËR SHTESA NË VENDIMIN NR. 26 DATË 24.07.2020 "MBI MIRATIMIN
E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR KONKURIM, REGJISTRIMIT TË
FITUESVE, PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, NË UNIVERSITETIN E
SPORTEVE TË TIRANËS" TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të pikës 28, 29, të nenit 6, të nenit 49, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH", Statutin e UST, Urdhërit të përbashkët të QSHA dhe QNRRASH nr. 2 datë 02.07.2020 "Mbi miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë...", i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e Arsimit të Lartë", Urdhërit të Rektorit nr. 15 datë 26.08.2020 "Mbi miratimin e procedurave për aplikim për aplikim dhe regjistrim në programet e ciklit të parë të studimeve për kategori të veçanta kandidatësh", Urdhërit të Rektorit nr. 16 datë 26.08.2020 "Mbi miratimin e pranimeve në ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional" dhe "Master shkencor", Bordi i Administrimit,

V E N D O S I

1. Të miratojë shtesa në vendimin nr.26 datë 24.07.2020 "Mbi miratimin e tarifave të regjistrimit për konkurim, regjistrim të fituesve, për ciklin e parë të studimeve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës" të ndryshuar.
2. Tarifat e regjistrimit në konkurimin praktik të aplikantëve, tarifa e aplikimit dhe tarifa e regjistrimit të fituesve të kandidatëve nga trojet, kandidatëve me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian në programet e ciklit të parë, transferim studimesh dhe program të dytë studimit, për vitin akademik 2020-2021, janë të njëjta me tarifën e miratuar më parë për ciklin e parë të studimeve.
3. Tarifat e aplikimit të kandidatëve, kandidatëve për transferim studimesh e të tjerë dhe tarifa e regjistrimit të fituesve për ciklin e dytë të studimit (program i parë/ program i dytë), për vitin akademik 2020-2021, sipas tabelave bashkëngjitur.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, Dega e Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në www.ust.edu.al dhe tek portali i transparencës universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Hysen Domi



Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes**Tab 1**

Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të dytë të studimeve program i pare i studimeve)	2500lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve dhe transferimet e studimeve dhe të tjerë)	3000lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i pare i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2000lekë

Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit**Tab 2**

Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të dytë të studimeve program i pare i studimeve)	2500lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve dhe transferimet e studimeve dhe të tjerë)	3000lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i pare i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2000lekë